



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 54, datë 29. 09. 2022

“PËR MIRATIMIN E VLERËS PARAPRAKE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË TË PALUAJTSHME QË PREKET NGA PROJEKTI: RIGJENERIMI URBAN I ZONËS AFËR GJIMNAZIT NË RRUGËN E DËSHMORËVE ÇOROVODË”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29. 09. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Komisioni i Shpronësimeve, në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 2.1, gërma “b”, neni 54, Ligjit Nr.8561, datë 22. 12. 1999, “Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik”, i ndryshuar, VKM-në Nr. 127, datë 23. 03. 2000, “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, VKM Nr. 138, datë 23. 03. 2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, VKM-në Nr. 89, datë 03. 02. 2016, “Për miratimin e Hartës së vlerës të tokës në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës paraprake të shpronësimit prej 675 000 lek, për interes publik të pronarit të pasurisë të paluajtshme që preket nga projekti: Rigjenerimi urban i zonës afër gjimnazit në rrugën e “Dëshmorëve” Çorovodë.

Emri i pronarit	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja që shpronësohet	Shënime
Batjar Ibrahim Laze	11/51	ndërtesë	1420	18 m ²	Konfirmim nga ASHK Skrapar

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vendimi u miratua me 10 vota pro, vota kundër - 1, vota abstenim – s’ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI